

PUNIMET E NDËRTIMIT

Kryerja e procesit të ndërtimit dhe të mirëmbajtjes

Referuar dispozitave të ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, operacionet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit dhe mirëmbajtjes, janë furnizime shërbimi. Furnizimi i këtyre shërbimeve është i tatueshëm për qëllim të TVSH-së.

Ndërtimi përcaktohet si çdo operacion që ka për rezultat përfundimin tërësor ose pjesor të një ndërtese të re ose substancialisht të ndryshuar. Mirëmbajtja përcaktohet si çdo operacion i kryer mbi tokë ose në ndërtesë, për të parandaluar degradimin ose dëmtimin dhe për t'i mbajtur token dhe ndërtesat me pamje të mirë dhe rregull funksionimi, duke përfshirë pastrimin.

Punime që kanë të bëjnë me procesin e ndërtimit, pa u kufizuar vetëm në to, janë:

- i) Punimet e ndërtimit të ndërtesave dhe punime të tjera të ndërtimit;
- ii) punimet për pajisjen e ndërtesave që kanë si efekt të përfshijnë përfundimisht vendosjen e aparateve apo materialeve të instaluar;
- iii) punimet e restaurimit dhe të riparimit të ndërtesave, si dhe instalimet me karakter të paluajtshëm.

Në punimet e ndërtimit bëjnë pjesë:

- i) punimet e ndërtimit që kryhen nga grupe të ndryshme profesionale që marrin pjesë në ndërtimin e ndërtesave të tilla si gjurmimet, krijimi i themeleve, spastrimi dhe nivelimi i territorit, pusët dhe gjurmimet paraprake për ndërtimin e pasurive të paluajtshme, punimet e ekipit të terrenit, fasada, etj.;
- ii) punët publike të tilla si: rrugët, hekurudhat, urat dhe të gjitha veprat e artit, pistat e fluturimit, stadiumet, etj.;
- iii) punimet me fletët metalike të ndërtesave si dhe ndërtimet metalike të tilla si punimet e grumbullimit apo të qarkullimit;
- iv) punimet e rregullimit të territorit që sjellin modifikimin e relievit ekzistues të tilla si: zbulimet e gurore, nivelim i shpateve; gjurmimi dhe mbushja e gropave; spastrimi i dheut, etj.

Për disa punime që lidhen me ndërtesat dhe me pasurinë e paluajtshme gjithashtu, edhe pse qëllimi kryesor nuk është ndërtimi i objektit, konsiderohen si furnizime shërbimi të tilla si: pastrimet e caktuara vetëm për mirëmbajtjen dhe hapjen e kanaleve të vegjël në porte, lumenj, etj.

Punimet që përfshihen në punimet për pasurinë e paluajtshme

Punimet e instalimit që përmbajnë vendosjen e elementeve që e humbin karakterin e tyre të luajtshëm për shkak të përfshirjes së tyre në një tërësi të paluajtshme, për zbatimin e TVSH-së duhet të konsiderohen, si pjesë e pasurisë të paluajtshme. Konsiderohen si të tilla kur heqja e materialit të instaluar nuk mund të kryhet pa dëmtime të rënda që pëson ky material apo ndërtesa që e mban atë.

Operacionet që bëjnë pjesë në punimet në pasuritë e paluajtshme:

- i) Instalimet dytësore në ndërtimin e ndërtesave të tilla si instalimet elektrike (drita, energjia, zilja); instalimet sanitare (lavamanë, dushe, pllaka dushi); instalimi i aparateve që prodhojnë ujë të ngrohtë të përfshira në ndërtesë; instalimi i ngrohjes, i pajisjeve hidraulike, për thithjen e tymit etj; instalimi i shtresave të dyshemesë, etj;
- ii) Punimet që nuk përfshihen në punimet për pasuritë e paluajtshme janë ato të cilat, cilado qoftë natyra e ndërtesës ku kryhen instalimet e objekteve apo aparateve të luajtshme, në momentin që vendosen e ruajnë karakterin e tyre të luajtshëm.

Punimet e restaurimit apo të riparimit

Punimet e restaurimit apo të riparimit që kanë si qëllim rinovimin e një ndërtese apo të një instalimi me karakter të paluajtshëm, konsiderohen si punime në pasuritë e paluajtshme

Konsiderohen si të tilla kur operacionet e realizuara përmbajnë vendosjen e materialeve apo të elementeve që integrohen në një pasuri të paluajtshme ose kur këto operacione kanë si qëllim zëvendësimin e elementeve të përdorura të një instalimi me karakter të paluajtshëm ose shtimin e elementeve të reja që përfshihen në këtë instalim apo në ndërtesën që i mban ato. Nga këto operacione, mund të citojmë:

- i) restaurimin e fasadave që përmban punimet për pastrimin e fasadave të ndërtesave të vjetra apo që mund të integrohen në një cikël të plotë të ndërtimit të ri;
- ii) riparimi i çative, oxhaqeve, parketeve, dyerve dhe dritareve.